 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) *çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

➤ LOTI 1 BLERJE MATËS TË SHPEJTËSISË (RADAR/ SHPEJTËSI MATËS)

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

SPECIFIKIMET TEKNIKE – SISTEMI I MATJES SË SHPEJTËSISË LIDAR

A. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME

Sistemi i matjes së shpejtësisë me LIDAR është një platformë e integruar për zbatimin e rregullave të trafikut, që kombinon modul lazer 905 nm me fuqi nominale 90 mikrowat, optikë të projektuar posaçërisht, kamerë me rezolucion të lartë, njësi elektronike përpunimi me procesor embedded multi-core ≥ 1 GHz për përpunimin e të dhënave LIDAR dhe video në kohë reale. Sistemi lejon matje të saktë të shpejtësisë 0–320 km/h në afrim/largim, regjistrim video/foto dhe enkriptim AES-128.

B. VERSIONET E MUNDSHME

B1. Variacione të dorëzimit

Varianti	Përshkrimi
Version dorëmbajtës	Përdorim mobil nga operatori në terren; bateri të brendshme dhe ekran me prekje.
Version me tripod	Montim në tripod për kapje të qëndrueshme dhe punë të zgjatur në një pikë kontrolli.
Version i integruar në automjet	Montim në automjet patrullues; lidhje me ekran kabine dhe furnizim 12V DC.

C.SPECIFIKIME TEKNIKE SIPAS KOMPONENTËVE

C1. Kutia e sensorit (optika + lazer)

Kërkesë minimale	Karakteristika e ofruar
Gjatësia valore e lazerit	905 nm (nominale)
Fuqia e lazerit	90 mikrowat (vlerë nominale)
Shpërndarja e rrezes	2.5 miliradian (vlerë nominale)
Siguria e syrit	Klasë 1 FDA (CFR 21) dhe IEC 60825-1
Gama optimale e lentes	Deri në 175 m e rekomanduar

C2. Moduli LIDAR (matës)

Kërkesë minimale	Karakteristika e ofruar
Distanca maksimale e matjes	1,200 m
Distanca minimale e matjes	15.25 m (modalitet i shpejtësisë); 61 m (modalitet i motit)
Saktësia e distancës	± 15 cm (absolute)
Gama e shpejtësisë	0–320 km/h (afirm dhe largim)
Saktësia e shpejtësisë	± 2 km/h
Koha e matjes	0.33 sekonda

Mostrimi maksimal i lazerit	Deri në 3 matje në sekondë
Njësiti e matjes	Shpejtësia në km/h; Distanca në metra

C3. Kamera dhe ekran

Kërkesë minimale	Karakteristika e ofruar
Sensori i kamerës	5 megapiksel (2592 × 1944)
Madhësia e imazheve	1200 × 960 piksel
Madhësia e videove	2400 × 1800 (cilësi e lartë) ose 1200 × 900 (standard)
Optika	Lentë e projektuar posaçërisht; fokus automatik; diafragmë automatike; mbyllje automatike; filtër automatik ditë-natë
Ekрани	9.4 cm, 480 × 640 piksel, 24 bit, ekran me prekje

C4. Karta e sinkronizimit

Kërkesë minimale	Karakteristika e ofruar
Funksioni	Sinkronizim i matjeve të LIDAR-it me videon/foton dhe metadata (koordinata, kohë, shpejtësi).
Saktësia kohore	Koherencë me orën reale të brendshme (± 20 PPM; jetëgjatësi 5 vjet).
Integrimi	Shkarkim automatik dhe lidhje me njësinë elektronike për përpunim në kohë reale.

C5. Kutia elektronike (CPU + elektronika e brendshme)

Kërkesë minimale	Karakteristika e ofruar
Përpunuesi (CPU)	Pajisja duhet të ketë procesor të integruar me arkitekturë 32-bit ose 64-bit, me të paktën dy bërthama përpunimi dhe frekuencë jo më pak se 1 GHz, I aftëtë të ekzekutojë në mënyrë të qëndrueshme

	sistem operativ embedded dhe aplikacione komunikimi në kohë reale.
Memoria e sistemit	64 MB SDRAM
Magazini	Kartë SD deri 32 GB; sisteme skedarësh FAT16/FAT32/EXT2/EXT3
Sistemi operativ	Linux me Driver
Enkriptimi i të dhënave	AES-128 (në përputhje me FIPS)
Mbrojtja anti-blokim	Sistem mbrojtës ndaj pajisjeve që bllokojnë sinjalin (Anti-Jam)
Portat & ndërfaqet	RS232 ose RS485; Rrjet pa tela IEEE 802.11 a/b/g/n; Ethernet 100M/1G; USB 5V DC; 6 butona hyrës

C6. Tripodi

Kërkesë minimale	Karakteristika e ofruar
Kapacitet mbajtës	≥ 2.5 kg
Lartësia minimale	140 cm
Ndërtimi	Konstruksion metalik me stabilitet të lartë ndaj dridhjeve

C7. Parametra fizikë dhe mjedisore

Kërkesë minimale	Karakteristika e ofruar
Trupi	Polikarbonat kompozit me shasi alumini të brendshme
Pesha	1.6 kg (me bateri)
Përmasat	21.0 × 9.8 × 31.7 cm
Mbrojtja mjedisore	NEMA 4 / IP55 (rezistent ndaj ujit dhe pluhurit)
Temperatura e punës	-10°C deri +60°C
Temperatura e karikimit	0°C deri +45°C

C8. Energjia

Kërkesë minimale	Karakteristika e ofruar
Paketa e baterisë	7.4 V DC, polimer litiumi; deri 8-10 orë punë pa kablo
Karikuesi kryesor	110–240 V AC; 50/60 Hz
Karikuesi automatik	11–16 V DC; prizë për karikim në automatik; siguresë 3 A

D. Të dhëna specifike për softuerin

Kërkesë minimale	Karakteristika e ofruar
Modalitetet e punës	Modalitet manual; modalitet automatik; modalitet i natës; modalitet kapje targe pasme; modalitet me dy kufij shpejtësie; aplikacion tPrint për Android
Madhësia e imazhit	1200 × 960 piksel
Menaxhimi i të dhënave	Shkarkim/transferim përmes Wi-Fi/Ethernet/SD; integrim me back-office
Siguria	Enkriptim AES-128; ruajtje e paprekshme e provave (tamper-proof)

E. GARANCIA DHE MIRËMBAJTJA

E1. Kushtet e garancisë & mirëmbajtjes

Kërkesë minimale	Karakteristika e ofruar
Periudha e garancisë	Minimum 12 muaj (pjesë + punë) dhe përditësim software pa pagesë.
Servisi brenda garancisë	Mirëmbajtje nga servis i autorizuar nga prodhuesi me pjesë origjinale.
Koha e reagimit	Diagnozë brenda 3 ditëve pune; riparim/zëvendësim sipas marrëveshjes së SLA.

Dokumentacioni	Certifikatë origjine (COO), CE/FCC, ISO 9001, IP55, NEMA 4.
----------------	---

F. Kërkesat minimale & Kriteret e pranimit

Elementi	Përshkrimi
Përputhshmëria	Pajisja duhet të përmbushë të gjitha parametrat e këtij dokumenti pa devijime.
Testimi në terren	Verifikim funksional dhe i saktësisë së matjeve sipas manualit të prodhuesit.
Transmetimi i të dhënave	Demonstrim i suksesshëm i shkarkimit/transmetimit në sistemet/serverin e autoritetit kontraktor.

G. Kërkesat minimale & Përfshirjet në furnizim

Artikulli	Përshkrimi
Sistemi LIDAR i plotë	Njësi matëse me kamerë, modul LIDAR, CPU, ekran, bateri.
Tripod profesional	Me kapacitet mbajtës ≥ 2.5 kg dhe lartësi min. 140 cm.
Aksesore & kablllo	Kabllo komunikimi, karikues 220V dhe karikues automjeti.
Media memorie	Kartë SD 32 GB.
Software	Aplikacionet e prodhuesit për menaxhim, tPrint për printim mobil.
Dokumentacion	Manual përdorimi në shqip/anglisht; certifikata origjine dhe kalibrimi.
Afati i levrimit	Të jetë brënda 20 diteve

Kërkesa Shtesë Teknike

Kërkesë minimale	Karakteristika e kërkuar
Program kompjuterik (software)	Pajisja duhet të shoqërohet me program kompjuterik për terren dhe zyrë, pa licencë vjetore dhe pa pagesë abonimi.
Miratim tipi (Type-Approval)	Pajisja duhet të ketë miratim tipi të vlefshëm nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian.
Siguria për rrezatimin lazer	Pajisja duhet të jetë e certifikuar sipas standardeve evropiane të sigurisë për sytë, Klasa 1.
Konfigurimi i kufijve të shpejtësisë	Pajisja duhet të mundësojë konfigurimin e të paktën dy kufijve të ndryshëm të shpejtësisë.
Monitorimi i korsive	Pajisja duhet të jetë e aftë të monitorojë minimalisht dy korsitë qarkullimi automatikisht.
Ndërfaqja e përdoruesit	Pajisja duhet të ofrojë ndërfaqe funksionimi në gjuhën shqipe.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

➤ **LOTI 2 BLERJE PAJISJE PËR KONTROLLIN E ALKOOLIT (ALKOLTESTUES)**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara,

duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në *Specifikimet Teknike*, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin dhe energjinë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Specifikimet e Tenderit për pajisjen matëse të alkoolit në frymëmarrje

Karakteristikat

Pajisje matëse dore për përdorim profesional, e cila përshtatet lehtësisht me kërkesat, normat dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përveç saktësisë së kërkuar të matjes dhe konfigurimeve lokale, duhet të jete gjithmonë e lehtë dhe intuitive për t'u përdorur.

Kërkohet një dizajn modern dhe i orientuar drejt praktikës, i cili siguron mbajtje të lehtë, mbajtje dhe funksionim të rehatshëm dhe zvogëlon rreziqet e mundshme të infeksionit përmes masave konstruktive.

Pajisja duhet të ofrojë dhe si opsion që të jetë në gjendje të testojë atmosferën e ambientit për alkool para një testi të dyshimtë.

Teknologjia e matjes : Sensor Elektrokimik , teknologji 1/4'', selektiv vetem per etalon. Metoda e testimit : test aktiv me gojeza dhe test pasiv me hinke , me kalim te menjehershem nga hinka te gojeza.

Pajisja duhet të ketë një sistem sensorësh elektrokimikë , specifik për etanolin. Ky sensor EC duhet të jetë i projektuar për numër dhe/ose sekuencë të lartë testesh, duhet të tregojë alkool deri në 6 promil dhe duhet të ketë një interval kalibrimi prej 12 muajsh.

Pajisja duhet të jetë e pajisur me një software modular për dokumentimin dhe analizën e testeve, që mund të regjistrojë dhe dokumentojë rezultatet e testeve dhe të dhëna të tjera të kërkuara.

Me një set baterish alkaline (standarde AA), minimum që pajisja duhet të jetë në gjendje të kryejë deri në 1.500 teste. Kur përdoren bateri litiumi të integruara, minimum që pajisja duhet të jetë në gjendje të kryejë deri në 5.000 teste.

Temperatura e funksionimit duhet të jetë midis -10°C dhe $+55^{\circ}\text{C}$. Pajisja duhet të jetë e përdorshme për aplikime mobile, kështu që duhet të përshtatet p.sh. në xhepin e këmbës ose në xhepin e këmbës së uniformës së policisë.

Pesha e pajisjes nuk duhet të kalojë 290g .

Alkool ne frymemarrje 0-3.0 mg/L

Alkool ne gjak (BAC) : 0.00-6 %

Koha e nisjes jo me shume se 2 sekonda

Koha e shfaqjes së rezultatit jo me shume se 10 sekonda

Memorie minimale : 100.000 teste te ruajtura

Ekran TFT Color 2.4''

Minimumi të ketë Mundesi per te realizuar 12 matje ne minute

Per pajisjen garancia jo me pake se 12 muaj

Përdorimi

Pajisja matëse e alkoolit në frymë duhet të jetë e lehtë dhe e sigurt për t'u përdorur dhe nuk ka nevojë për trajnim të mjaftueshëm për t'u përdorur. Të gjitha funksionet e matjes duhet të kryhen me një buton. Si opsionale, duhet të jetë e mundur një modalitet testimi pasiv dhe një test frymëmarrjeje pa kontakt.

Kërkohet një analizë e shpejtë dhe e saktë, si dhe një diferencim i saktë i rezultateve të matjes. Prodhuesi i pajisjes matëse të alkoolit në frymë duhet të krijojë një certifikatë përputhshmërie me normën EN 15964, testimi duhet të kryhet nga një shtëpi testimi e jashtme me akreditim të përshtatshëm.

Pajisja duhet të ofrojë një gatishmëri shumë të shpejtë për matje, e cila siguron një reagim të menjëhershëm dhe lejon një numër të lartë testesh brenda një kohe të shkurtër.

Pajisja matëse e alkoolit në frymë duhet të jetë gati për përdorim pas afërsisht 3 sekondash pas ndezjes. Rezultati i testit duhet të shfaqet pas afërsisht 3 sekondash (në 0 mg/L) dhe afërsisht 10 sekondash (në 0.5 mg/L) në temperaturën e dhomës.

Pajisja duhet të ketë një konsum të vogël energjie që siguron një numër të lartë testesh.

Pajisja duhet të ofrojë një cilësi matjeje të dukshme sipas normës NHTSA (SHBA) për aplikim profesional.

Pajisja duhet të funksionojë në gjuhën kombëtare Shqiptare. Ndërveprimet e optimizuara duhet të minimizojnë dështimet e mundshme të përdoruesit. Regjistruesi i integruar i të dhënave duhet të ruajë deri në 10.000 rezultate testimi.

Interval Kalibrimit 12 muaj.

Pajisja duhet të shoqërohet dhe të paraqitet detyrimisht certifikate OIML (Organizata Internacionale e Metrologjisë Ligore).

Dokumentimi / printimi i të dhënave

Rezultati i matjes duhet të jetë i aftë të printohet pas çdo testi. Për këtë qëllim, kërkohet një printer celular. Rezultati i matjes duhet të transmetohet nëpërmjet Bluetooth. Nuk duhet të nevojitet kabllo lidhjeje. Rezultatet e ruajtura të testit duhet të jenë të aftë të printohen më vonë.

Komunikimi i të dhënave

Regjistruesi i të dhënave duhet të lexohet nëpërmjet një programi kompjuterik. Për më tepër, ky program kompjuterik duhet të ofrojë mundësinë për të ngarkuar skedarë specifikë të parakonfiguruar të klientit në pajisje, p.sh. parametrat matës.

Furnizimi me energji

Furnizimi me energji duhet të mbulohet nga bateri standarde alkaline (Mignon 1.5 V, LR6, AA), bateri komerciale të rikarikueshme NiMH 1.2V (LR6 ose AA, më shumë se 2.1 Ah) ose bateri primare litiumi. Nuk duhet të jetë i nevojshëm një konvertim nga funksionimi me bateri në funksionimin me bateri të rikarikueshme.

Varianti i pajisjes me një bateri litiumi të instaluar përgjithmonë duhet të jetë në gjendje të karikohet duke përdorur një kabllo USB C.

Statusi në Pritje

Pajisja duhet të ofrojë një funksion fikjeje automatike pas 240 sekondash mosaktiviteti. Pajisja duhet të fiket automatikisht gjithashtu, në rast se bateritë janë të zbrazëta. Në këtë rast, ekrani duhet të shfaqë simbolin "bateri e zbrazët".

Struktura fizike

Struktura duhet të jetë i bërë nga material i fortë, i cili është jashtëzakonisht rezistent në krahasim me ekspozimin atmosferik, p.sh. temperaturat ose lagështia e ulët. Për më tepër, pajisja duhet të përmbushë klasën e mbrojtjes IP54.

Rrip dore/lak dore

Një lak dore duhet ta mbrojë pajisjen nga, për shembull, rënia aksidentale ose goditja nga dora e përdoruesit.

Kalibrimi

Një procedurë e optimizuar kalibrimi do të zvogëlojë përpjekjen e kalibrimit. Kalibrimi duhet të kryhet ose me gaz të lagësht ose me gaz të thatë. Kalibrimi duhet të jetë i nevojshëm vetëm çdo 12 muaj.

Lidhja e gojzave

Duhet të jenë të mundshme dy lidhje të ndryshme. Një lidhje duhet të lejojë përshtatjen e grykës nga ana e djathtë dhe e majtë.

Një tjetër mundësi do të jetë përshtatja e hinkave për të kryer matje pa kontakt, p.sh. teste serike të disa personave me radhë.

Gojëza

Gojëza duhet të sigurojë një trajtim intuitiv dhe kosto të ulëta për test.

Çdo gojëza duhet të jetë e vetme dhe e paketuar në mënyrë higjienike. Si përshtatja e gojzës ashtu edhe heqja e gojzës duhet të garantojnë standardin më të lartë operativ të higjienës. Personi që kryen testin dhe operatori duhet të mbrohen sa më shumë që të jetë e mundur. Për këtë arsye, gojëza duhet të ketë një distancues (gojë-pajisje) dhe një nxjerrës.

Distancuesi në gojëza duhet të parandalojë kontaktin e buzëve të të dyshuarit me pajisjen.

Hapja, përshtatja dhe nxjerrja e gojzës duhet të jetë e mundur edhe me doreza.

Gojëzat me ose pa valvulë moskthimi duhet të ofrohen si opsion.

Printer portativ

Printeri portativ ofron printim të shpejtë (shpejtësi printimi deri në 100 mm për sekondë). Përdor rula letre termike.

Printeri duhet të ketë një bateri të rikarikueshme që karikohet brenda pajisjes. Jetëgjatësia e baterisë është deri në 24 orë.

Pajisja është e lehtë për t'u përdorur duke përdorur vetëm dy butona dhe është shumë e lehtë (250g duke përfshirë letrën dhe bateritë).

Pajisja duhet të lidhet me Alcotest nëpërmjet Bluetooth brenda një rrezeje deri në 15 metra.

Duhet të funksionojë në temperatura nga -15°C deri në $+50^{\circ}\text{C}$ dhe lagështi relative midis 10 – 80% rh ose më shumë.

Pajisja duhet të jetë e pajisur me certificate OIML.

Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e vet një person Ing : Elektrik/Elektronik etj I cili të jetë I trajnuar dhe I pajisur me certificate për të bërë e mundur , servisimin dhe mirëmbajtjen gjatë kohës së garancisë

Operatori ekonomik duhet të leshojë certificate trajnimi për përdoruesit për këto pajisje (Certificate nga Prodhuesi)

Pajisja duhet të jetë e pajisur me një software modular.

Ofertuesi duhet të paraqesë dokument autorizimi nga prodhuesi.

Mungesa e autorizimit sjell skualifikim të menjëhershëm.

Afati i lëvrimit të bëhet brenda 20 ditëve.

Të gjitha specifikimet teknike të përshkruara më sipër janë kërkesa minimale funksionale dhe performancë. Referencat eventuale ndaj standardeve, teknologjive ose konfigurimeve duhet të kuptohen si "ose ekuivalente".

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

LOTI 1: PAJISJE MATËSE TË SHPEJTËSISË (RADAR/ SHPEJTËSI MATËS)**Shtojca 7.**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**Sasia e mallit që kërkohet:**

Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
	Pajisje matëse të shpejtësisë (radar/ shpejtësi matës)	7	Drejtoria e Pergjithshme e Policisë së Shtetit	24 Muaj

Afatet e lëvrimit:

Afati i lëvrimit të mallit për këtë objekt, pas nënshkrimit të kontratës do të jetë 20 (njëzet) ditë

Do te lidhen disa minikontrata, brenda afatit te marreveshjes kuader dhe fondit limit te parashikuar, sipas kerkesave dhe nevojave te Autoritetit Kontraktor.

LOTI 2 Pajisje për kontrollin e alkoolit (alkooltestues)

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
	Pajisje për kontrollin e alkoolit (alkooltestues)	55	Drejtoria e Pergjithshme e Policisë së Shtetit	24 Muaj

Afatet e lëvrimit:

Afati i lëvrimit të mallit për këtë objekt, pas nënshkrimit të kontratës do të jetë 20 (njëzet) ditë

Do te lidhen disa minikontrata, brenda afatit te marreveshjes kuader dhe fondit limit te parashikuar, sipas kerkesave dhe nevojave te Autoritetit Kontraktor.

Pajisje matëse të shpejtësisë (radar/ shpejtësi matës)

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerë

së fondit limit të lotit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike/broshurë për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë **Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin /distributorin** e autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **ekuivalent** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **certifikatë konformiteti CE** (ose deklaratë konformiteti DC), ose **certifikimin FDA**.

2.3.6 Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, për të realizuar instalimet, konfigurimet e pajisjeve objekt prokurimi operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik si më poshtë vijon:

a .Të paktën 1(një) inxhinier Elektronik/ Telekomunikacioni

Operatori ekonomik në lidhje me inxhinierin e kërkuar më sipër duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

Në lidhje inxhinierin:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Diplomë universitare (Bachelor ose Master).
- Listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shenim: Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.6 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit e mallit objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues konform specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti 2: Pajisje për kontrollin e alkoolit (alkooltestues)

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit objekt prokurimi. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare

vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike/broshurë për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit.

